



Shkollat Publike Worcester

Worcester, Massachusetts



Zyra e Mbikqyrëses
Maureen F. Binienda
Mbikqyrëse

Dr. John E. Durkin Administration Building
20 Irving Street
Worcester, Massachusetts 01609-2493

Tel. (508) 799-3115
FAX (508) 799-3119
biniendam@worcesterschools.net

20 Maj, 2020

Të Dashur Prindër/ Kujdestarë,

Shpresoj të jeni mirë dhe të përshtateni me "normalen" tonë të re. Unë dua t'ju falënderoj për lidhjen me arsimtarët, këshilltarët dhe drejtorët tanë. Unë admiroj punën që keni bërë në detyrën tuaj si mësues për punën me stafin tonë për të mësuar programin mësimor. Faleminderit që na futët në shtëpitë tuaja në google chat, klasat google, zëri google dhe telefonatat Zoom. Gjatë nëntë javëve të fundit, puna mësimdhënëse dhe mësimore e WPS ka kaluar nga "Mësimi i Zgjeruar" në "Mësimin në Distançë" dhe tani në "Mësimin në Distançë Plus". Fokusi kryesor i "Mësimin në Distançë Plus" aktual është tu ofrojë nxënësve me udhëzime të reja që do të lidhin mësimin e tyre për të përmbushur standardet e 2020-21. Mësuesit po japin orare për takimet në Google, klasën e Google dhe mësimet e regjistruara. Mësuesit, këshilltarët dhe stafi ndihmës po kontaktojnë nxënësit për të kontrolluar shëndetin e nxënësve dhe të familjeve dhe dhënien e mbështetjes akademike. Shkollat Publike Worcester gjithashtu dërguan në shtëpi paketa për nxënësit që nuk kanë akses në internet. Mësuesit po japin feedback të vazhdueshme për punën e nxënësve. Unë jam shumë mirënjohëse për bisedat personale dhe punën që keni bërë me mësuesit tanë në lidhje me edukimin e vazhdueshëm të fëmijës tuaj. Unë kam bashkangjitur përditësimin më të fundit arsimor të Komisionerit të Arsimit për referencën tuaj

Unë po ju shkruaj për të ndarë me ju përditësime të tjera për nxënësit e Shkollave Publike Worcester:

Dita e fundit e shkollës për Maturantët është 27 Maj, 2020. Shkollat Publike Worcester kanë paguar për kapelet dhe fustanet (gowns) e të gjithë maturantëve këtë vit. Kapelet dhe fustanet (gowns) e nxënësve janë dërguar në adresën e çdo maturanti, me përjashtim të Worcester Tech, Gerald Creamer Center dhe St. Casmir's. Maturantët gjithashtu do të marrin informacion nga drejtorët e tyre për kthimin e AP Chromebook, pikat e nxehta dhe librat shkollorë. Drejtorët kanë kontaktuar maturantët dhe familjet e tyre me informacione në lidhje me diplomimin e tyre virtual dhe planet për shpërndarjen e diplomave të nxënësve.

Vala e parë e Chromebooks u shpërnda tek nxënësit që nuk kishin një pajisje elektronike në shtëpitë e tyre të Premte, 15 Maj. Vala e dytë e shpërndarjes së Chromebooks do të fillojë javën e 26të Majit.

Familjet do të marrin një telefonatë nga stafi i shkollës që tregon se nga cila shkollë do të marrin Chromebook-un e tyre, si dhe datën dhe orën. Kjo do të lejojë distancimin shoqëror dhe një zgjedhje të shpejtë. Kjo do të lejojë distancimin shoqëror dhe një marrje të shpejtë. Adresa e Internetit të Mësimin të Zgjeruar të Shkollave Publike Worcester (<https://sites.google.com/worcesterschools.net/wpsextendedlearning/home>) ka aktivitete mësimore të cilat mund të aksesohen tani dhe gjatë verës nga nxënësit e të gjitha moshave. Shkollat Publike Worcester kanë paguar gjithashtu për shumë APPS edukative për nxënësit që ti përdorin tani dhe gjatë verës për të zhvilluar aftësitë e tyre.

Nuk do të ketë nota të nxjerra për tremujorin 4^r. Përrjashtim bëjnë Edukukimi Fizik i shkollave të mesme, Akademia Reach, Shkolla e Mesme të Kolegjit të Hershëm, dhe Programi e Ditës dhe Mbrëmjes së Qendrës Gerald Creamer. Nota përfundimtare përcaktohet nga mesatarja e tre termave të parë. Nxënësit mund të fitojnë nga një deri në katër pikë të notes së tyre përfundimtare të klasës e tyre duke përfunduar detyrat e dhëna nga mësuesit duke filluar nga 10 maji. Mësuesit do të japin një deri në katër pikë në rubrikën e feedback-ut. Kjo vlen si për punën jo-teknologjike ashtu edhe atë dixhitale.

Nxënësit do të jenë në gjendje që të marrin sendet e tyre personale dhe të kthejnë librat në shkollat e tyre nga 8 Qershor- 12 Qershor. Drejtorët do t'ju kontaktojnë me proceset dhe oraret e çdo shkolle. Ne do të ndjekim udhëzimet e sigurisë së shtetit dhe ato federale.

Dita e fundit e shkollës për Shkollat Publike Worcester është të Premte, 12 Qershor. Kartat e raportit do të postohen. Listat me leximet e verës për nivelin e klasës dhe aktivitetet e sugjeruara të matematikës do të bashkangjiten.

Programet e shkollës së verës janë virtuale këtë vit. Shumica e programeve verore të shkollave do të mbahen nga 17 Qershori deri në 8 Korrik për nxënësit në klasat 2 deri në 12. Shkolla verore për edukimin special do të mbahet nga 6 Korriku - 6 Gusht. Familjet do të kontaktohen nga shkollat e tyre me më shumë informacion si dhe rreth mundësive shtesë për nxënësit që kualifikohen për programet verore.

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutem kontrolloni adresën e internetit të Shkollave Publike Worcester, [Worcesterschools.org](https://worcesterschools.org) nën "Pyetjet e Bëra më Shpesh" për të parë nëse marrin përgjigje pyetjet e tyre. Ju gjithashtu mund të dërgoni email (<https://worcesterschools.org/contact/>) ose telefononi zyrën time në 508-799-3115.

Me të gjitha efektet e trishtuara të Covid 19, ne kemi mësuar disa leksione me vlerë. Stafi i Shkollave Publike Worcester ka komentuar se angazhimi i vërtetë i familjes është thelbësor. Ata kanë përjetuar një lidhje më të thellë me nxënësit dhe familjet gjatë këtyre muajve të kaluar dhe janë të angazhuar për vazhdimin e kësaj. Ne e ndiejmë qartësisht rëndësinë e të punuarit së bashku në interesin më të mirë të secilit nxënës. Aftësitë tona teknologjike kanë pasur nevojë për tu përmirësuar sa më shpejt, ndërsa kaluam nga një platformë e mësimdhënies në mësimin aktual në distancë. Aftësitë teknologjike të nxënësve dhe familjeve gjithashtu janë zgjeruar. Shkollat Publike Worcester do të ofrojnë trajnime online për nxënësit, familjet dhe partnerët e komunitetit. Sapo shkolla të rifillojë, përdorimi i teknologjisë për të angazhuar nxënësit në mësimin e tyre do të jetë një pjesë e udhëzimeve të përditshme. Më në fund, mësuam se mënyra e vetme për të ecur përpara është të bashkohemi së bashku me kolegët, nxënësit, familjet tona si dhe me drejtuesit e komunitetit dhe agjensitë. Mezi pres që të përmirësojmë punën tonë së bashku.

Në Partneritet,

Maureen F. Binienda

Maureen F. Binienda